



VENDIM

Nr. 156, Datë 24.12.2015

MBI

**LENIEN NE FUQI TE VENDIMEVE NR .139, NR. 140, NR 141, NR.
145, NR. 146, NR. 147, NR. 148 DATE 26.12.2014 SI DHE TE
VENDIMIT NR. 27 DATE 16.02.2015 TE BORDIT TE
KOMISIONEREVE TE ERE PER PERIUDHEN 1 JANAR 2016 – 30
QERSHOR 2016**

Në mbështetje të neneve 10 pika 2, 16 20 gërma “c” dhe 109 pika 5, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, Nenit 15 pika 1 dhe 3 të Ligjit nr. 138/2013 “Për burimet e rinovueshme” i ndryshuar, nenit 15 të Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.03.2009, te ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 26.12.2015, pasi shqyrtoi, relacionin e Drejtorive Teknike si dhe rekomandimet e MEI për shtyrjen e afatit të tarifave dhe çmimeve të energjisë elektrike te miratuara për vitin 2015,

Konstatoi se:

- Hartimi i akteve nënligjore dhe rregullatore përkatëse në përputhje me Ligjin 43/2015 nuk ka përfunduar.
- Mbyllja e detyrimeve të ndërsjellta midis tre operatorëve është ende në proces rakordimi dhe ende nuk ka përfunduar.
- Tre kompanitë publike nuk kanë paraqitur Planet e Investimeve për vitin 2016.
- Tre kompanitë publike nuk kanë paraqitur aplikimet për rishikimin e tarifave për vitin 2016.
- Konstatohet një situatë e përmirësuar e sektorit, e cila shërben si indikator i mjaftushmërisë së tarifave të vitit 2015 për kryerjen e një aktiviteti normal nga tre operatorët.
- Ministria e Energjisë dhe Industrisë si dhe tre kompanitë publike janë shprehur pro shtrirjes së efektit të tarifave dhe çmimeve aktuale te energjisë elektrike për 6 mujorin e parë të vitit 2016.

- Me vendimin e Këshillit të Ministrave Nr 1033 Datë 16.12.2015, botuar në fletoren zyrtare nr 221 datë 24.12.2015 është miratuar “Metodologjia e përcaktimit të tarifave fikse të energjisë që do t’i paguhet prodhuesve të energjisë elektrike nga Hidrocentralet”. Në këtë VKM, i cili i shtrin efektet e tij për vitin 2016, në nenin 2 të tij është parashikuar edhe se ERE ngarkohet me detyrimin për të saktësuar se cili do të jetë çmimi i shitjes së energjisë së prodhuar nga prodhuesit e vegjël të energjisë për periudhën e ndërmjetme deri në daljen e një çmimi që do të aplikohet për vitin 2016.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të lërë në fuqi deri në datën 30 Qershor 2016, tarifat dhe çmimet e miratuara përkatësisht me vendimet si më poshtë :
 - Vendimin nr. 139, datë 26.12.2014 “Për përcaktimin e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike nga KESH sh.a. për vitin 2015”.
 - Vendimin nr. 140, datë 26.12.2014 “Për përcaktimin e tarifës së energjisë elektrike për furnizuesin publik me shumicë për vitin 2015”.
 - Vendimin nr. 141, datë 26.12.2014, “Për përcaktimin e tarifës për shërbimet ndihmëse të KESH sh.a. për vitin 2015”.
 - Vendimin nr. 145, datë 26.12.2014, “Për përcaktimin e tarifës të transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a për vitin 2015”.
 - Vendimin nr.146, datë 26.12.2014 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2015 në nivelin e tensionit 35 kV”.
 - Vendimi nr. 147, datë 26.12.2014 “Për përcaktimin e tarifës mesatare të shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2015”.
 - Vendimi nr. 148, datë 26.12.2014 “Për përcaktimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tariforë për vitin 2015”.
2. Fuqia juridike e Vendimit Nr. 27 të Bordit të Komisionerëve të ERE, datë 16.02.2015 “Mbi miratimin e tarifës fikse të energjisë për vitin 2015, që do t’i paguhet prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet, zgjatet deri në marrjen e vendimit të shfuqizimit të tij nga Bordi i ERE.
3. Pas publikimit të Raportit vjetor (Physical futures Annual report) nga bursa e Hungarisë HUPX për vitin përkatës, siç përcaktuar në VKM Nr 1033 Datë 16.12.2015, ERE do të shprehet me vendim “Mbi miratimin e tarifës fikse

të energjisë për vitin 2016, prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet”.

4. Përditësimi dhe kompensimi i të gjitha efekteve të mundshme financiare për të licensuarit do të bëhet brenda vitit 2016.
5. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë të interesuarit për vendimmarrjen e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet ne Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit AHMETI